



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18.07.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gzim SHALA Shef i Prokurimit në Spitalin Rajonal Ferizaj
CC:	z. Gzim BAJRAMI Drejtor i Spitalit Rajonal Ferizaj
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull " Furnizim me Instrumente për Otopedi, Kirurgji, Urologji, Kirurgji Abdominale dhe Gjinekologji "

I nderuari z. Shala ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin me titull " Furnizim me Instrumente për Otopedi, Kirurgji, Urologji, Kirurgji Abdominale dhe Gjinekologji ", me nr. të prokurimit: 900-019-2014-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Furnizim me Instrumente për Otopedi, Kirurgji, Urologji, Kirurgji Abdominale dhe Gjinekologji ", me nr. të prokurimit: 900-019-2014-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit pranë Spitalit Rajonal në Ferizaj ka përgatitur njoftimin për kontratë me titull "Furnizim me Instrumente për Otopedi, Kirurgji, Urologji, Kirurgji Abdominale dhe Gjinekologji", me nr. të prokurimit: 900-019-2014-121, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.20.06.2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Agjencia, pasi ka ekzaminuar dhe krahasuar dokumentet e tenderit, ka hasur në disa të dhëna të cilat bien ndesh me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar faktet si në vijim:

Në njoftimin për kontratë, tek rubrika Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 15 Autoriteti kontraktues Spitali Rajonal në Ferizaj ka kërkuar nga Operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar të tenderojnë që të bashkëngjisin, Kontrata për punë të ngjashme ekskluzivisht të kësaj natyre kërkesë kjo në kundërshtim me ligjin, pasi që Legjislacioni në fuqi e parashihet se Autoriteti kontraktues mund të caktojë një kriter të tillë të përzgjedhjes për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorit ekonomik, **por nuk lejohet në asnjë mënyrë që një kërkesë të tillë ta kërkojë për të dëshmuar aftësinë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të Operatorëve ekonomik.**

Tek rubrika Kapaciteti teknik ose profesional në njoftimin për kontratë pika 3 është kërkuar që **produktet e ofruara duhet të jenë të prodhuara në shtetet e Bashkimit European (vendet e zonës Shëngen), Zvicër, SHBA, Kanada, Australi, Japoni dhe Izrael,** kërkesë kjo për të cilën gjithashtu konsiderojmë se bie ndesh me LPP-në ku thuhet se *"Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik "*. Autoriteti Kontraktues me formulimin e kësaj kërkesë ka përcaktuar vendin e origjinës së këtyre pajisjeve. Duke e përcaktuar vendet e origjinës për pajisjet furnizuese, mund të krijohen kushte favorizuese për prodhues apo Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminohen të tjerët. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që të kërkojë që pajisja të jetë e kualitetit të lartë apo ti referohet një standardi vendor, european ose ndërkombëtar, por nuk është e lejuar të kërkojnë pajisjet ose produktet nga ndonjë vend i caktuar. Bazuar në legjislacionin e Republikës së Kosovës i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik, një gjë e tillë është e ndaluar pasi që nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe të ligjshme.

Kufizimi i tillë territorial i cili është bërë nga Autoriteti kontraktues e kufizon konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik, prandaj konsiderohet shkelje e nenit 7 e LPP-së.

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me rubrikën Përshtatshmëria profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe rubrikën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, Agjencia konstaton

se kriteret e përzgjedhjes të këto rubrika të cilat janë caktuar, nuk janë identike çka paraqet mospërputhje në mes njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Në njoftimin për kontratë tek rubrika Përshtatshmëria profesionale është kërkuar autorizimi për pjesëmarrje në këtë tender nga prodhuesi- origjinali (i cili duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për prodhuesin, veçanërisht detalet e kontaktit si: adresa, numri i telefonit/faksit, e-mail adresa). Në rubrikën Kapaciteti ekonomik dhe financiar të njoftimit për kontratë, autoriteti kontraktues ka kërkuar tek pika 14 dhe 15 Qarkullim financiar dhe Kontrata për punë të ngjashme, si dhe tek rubrika Kapaciteti teknik dhe profesional tek pika 1 dhe 2 janë kërkuar certifikata mbi standardet ISO 9001 dhe 9002 apo ISO 13845:2003 dhe CE certifikata për produktet sterile, ndërsa tek pika 3 ka kërkuar që Produktet e ofruara duhet të jenë të prodhuara në shtetet e Bashkimit Europian -së (vendet e zonës Shëngen), Zvicër, SHBA, Kanada, Australi, Japoni dhe Izrael.

Kërkesat e cekura si më lartë të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë nuk janë kërkuar edhe në dosjen e tenderit lëshim ky nga ana e autoritetit kontraktues për të cilin konsiderojmë se nuk është në pajtim me dispozitat e LPP-së.

Mospërputhja e tillë në mes njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit mund të krijojë edhe paqartësi tek tenderuesit, Autoriteti kontraktues duhet që gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit ti kushtoj rëndësi dhe të kujdeset çdo herë që njoftimi për kontratë të jetë në pajtim me dosjen e tenderit.

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar ofertat origjinale me tërë dokumentacionin përcjellës për këtë tender pasi Autoriteti kontraktues ka përfunduar me procesin e vlerësimit të tenderëve. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionin të ofruar nga Autoriteti kontraktues, Agjencia ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti kontraktues me dt.30.06.2014 ka bërë hapjen e tenderëve, ndërsa vendimi për formimin e komisionit vlerësues i aprovuar nga Zyrtari Kryesor administrativ është nxjerr me dt.07.07.2014. Në këtë vendim thuhet se Komisioni fillon vlerësimin e ofertave me dt.07.07.2014.

Duke u bazuar edhe në deklaratat nën betim të nënshkruara nga anëtarët e komisionit vlerësues, Agjencia konstaton se vlerësimi i ofertave ka filluar 8 ditë pas hapjes së tenderëve, veprim ky për të cilin konsiderojmë se është në kundërshtim të plotë me Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik ku thuhet se "Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve".

Duke u bazuar në Procesverbalin e Operatorëve ekonomik që e kanë pranuar dosjen e tenderit dhe Procesverbalin e hapjes së tenderëve, Agjencia vëren se dosjen për këtë tender e kanë tërhequr 21 OE, ndërsa vetëm 2 Operator ekonomik i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë kontratë.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura si më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 35 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

